



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“Hartëzimi i kompetencave kyçe dhe rezultateve të të nxënit
në programet e mësuesisë, me fokus formimin e
kompetencave profesionale të studentëve të mësuesisë të
Universitetit të Tiranës”**

(HK-RN-SUT)

**FINANCUAR NGA UNIVERSITETI I TIRANËS
NË KUADËR TË PROGRAMIT “UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION”
2023**

EKIPI I PROJEKTIT:

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha (Udhëheqëse e projektit) – FGJH, UT

Prof. Dr. Andromaqi Haloçi – FGJH, UT

Prof. Asoc. Dr. Leticja Gusho – FSHS, UT

Prof. Asoc. Dr. Çlirim Duro – UT

Dr. Blerina Hamzallari – FSHS, UT

Msc. Sema Hysa – FGJH, UT

Msc. Ph.Dc. Enkelejda Bara – UT

Aktiviteti 1: Takim për përcaktimin dhe ndarjen e detyrave të ekipeve të punës

Në takimin e parë të grupit të punës u dakordësua mbi ndarjen e ekipeve të cilat do të punonin në lidhje me realizimin e detyrave të veçanta të projektit.

Për sa i përket pasqyrimit të standardeve të formimit lëndor të mësuesit u caktuan dy ekipe: ekipi i parë me analizën e silabuseve të programit të ciklit të dytë të studimit master shkencor, me drejtimin mësues të gjuhës frënge; dhe ekipi i dytë me analizën e silabuseve të programit të ciklit të dytë të studimit master shkencor, me drejtimin mësues biologjie.

Në ekip i tretë u caktua për të punuar me pasqyrimin e standardeve profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.

